



## PREZANTIM

# Master i Delokalizuar ITI-RI Strasbourg & FGJH-UT

MASTER NË GJUHË DHE NDËRKULTURALITET  
SPECIALITETI PËRKTHIM PROFESIONAL DHE INTERPRETIM,  
DEGA PËRKTHIM PROFESIONAL

Njëherazi

DIPLOMË UNIVERSITARE «DU 1 – MJETE DHE ORIENTIM  
PROFESIONAL NË PËRKTHIM »

<https://www.facebook.com/masterperkthim/?pnref=story>

## **Kush është ITI-RI?<sup>1</sup> ITI-RI- Instituti i Përkthyesve, Interpretëve dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare**

Që prej 30 vjetësh, ITI-RI, pjesë e Universitetit të Strasburgut, formon specialistë në fushën e përkthimit, interpretimit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Ai është një institut universitar, pjesë e njësive arsimore dhe shkencore Gjuhët dhe Shkencat Humane të Aplikuara. ITI-RI ofron mastera për studentët të cilët kanë një diplomë bachelor në *Përkthim, Interpretim apo Marrëdhënie ndërkombëtare*.

Të tre Masterat në fushën e Përkthimit njihen nga *Drejtoria e Përgjithshme e Përkthimit pranë Komisionit Europian* si tre ndër dhjetë studimet universitare më të mira franceze. ITI-RI është pjesë e *Shoqatës Franceze për Formimet Universitare në fushën e Përkthimit* si edhe e *rrjetit OPTIMALE*<sup>2</sup>.

Në vitin e parë (semestri 1&2) ITI-RI ofron një trung të përbashkët për të gjithë masterat në fushën e përkthimit. Në vitin e dytë (semestri 3&4) bëhet një ndarje sipas specialiteteve, përkatësisht përkthim profesional (ku përfshihen fusha të ndryshme të specialitetit), përkthim audiovizual dhe përkthim letrar.

Krahas formatit standard të diplomave, ITI-RI ofron dhe diploma të delokalizuara në Përkthim, si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjeve për bashkëpunim europian me shumë institucione arsimore të huaja. Institucionet që lëshojnë diplomën universitare të ITI-RI-së në përkthim/interpretim janë :

- Scientific College of Greece, Athinë.
- l'Institut Français de Thessalonique / I.F.T.
- l'Istituto Superiore per Interpreti e Traduttori de Milan / I.S.I.T.
- l'Université Hacettepe, Ankara (Turquie) / Université Hacettepe
- l'Université des Langues d'Azerbaïdjan / A.D.U.

## **Cilat janë përparësitë e këtij masteri të delokalizuar ?**

Bashkëpunimi mes Universitetit të Strasburgut - ITIRI dhe Universitetit të Tiranës – FGJH u jep mundësi studentëve shqiptarë të ndjekin po në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja studimet në vitin e parë *Master të delokalizuar me kohë të plotë në fushën e Përkthimit Profesional/Interpretim, dega Përkthim Profesional* sipas një programi të përbashkët të miratuar nga dy institucionet.

Studentët që ndjekin këtë profil marrin diplomën universitare *“DU 1 – Mjete dhe orientim profesional në Përkthim”* lëshuar nga Universiteti i Strasburgut, e cila përkon me përfundimin e

<sup>1</sup><http://itiri.unistra.fr/> faqe zyrtare

<sup>2</sup> (Optimising Professional Translator Training in a Multilingual Europe) është një Rrjet akademik i Erasmusit ku bëjnë pjesë 72 partnerë nga 32 vende të ndryshme të Europës (përfshire 28 vendet anëtare).

nivelit të parë Master. Ky vit akademik zhvillohet në dy semestra dhe përmban 60 kredite ECTS (30 kredite semestri I + 30 kredite semestri II).

### Pranimi i studentëve

Në këtë Master pranohen studentët që kanë mbaruar:

- nivelin Bachelor (180 kredite ECTS) në cilëndo degë studimi, në të gjitha universitetet:
- që zotërojnë në mënyrë të kënaqshme 2 (dy) gjuhë të huaja krahas shqipes.

Studentët duhet të kalojnë me sukses një test pranimi që konsiston në njohjen jo vetëm të gjuhës shqipe, por dhe të dy gjuhëve të huaja (*Shtojca I*). Po ashtu, studentët duhet të kenë njohuri të kënaqshme edhe mbi aktualitetin ndërkombëtar. Studentëve të regjistruar u jepet karta e studentit nga Universiteti i Strasburgut.

### Tarifat e aplikimit dhe të studimit

Studentët e pranuar në këtë nivel, do të paguajnë tarifat vjetore të shkollimit të kërkuara nga Universiteti i Strasburgut (rreth 612 Euro ose 74,575 lekë me kursin e këmbimit aktual), si edhe tarifën e regjistrimit të FGJH-së.

### Çfarë ndodh pas mbarimit të vitit të parë ?

Marrëveshja mes UT/FGJH dhe UFR LSHA/ITIRI është e vlefshme vetëm për vitin e parë Master. Pasi pajiset me diplomën e vitit të parë **Master 1 në përkthimin profesional** dhe «**DU 1 – Mjete dhe orientim profesional në Përkthim**» lëshuar nga Universiteti i Strasburgut, studenti ka mundësinë të vazhdojë vitin e dytë Master 2, sipas zgjedhjes së tij, në secilin prej universiteteve të mëposhtme:

1. Në **FGJH, Tiranë, Shqipëri** : meqenëse këtë status e ka fituar që vitin e parë. Plani mësimor i vitit të parë Master për studentët e FGJH dhe studentët e UFR LSHA/ITIRI është i njëjtë dhe shmang ekuivalentimin e krediteve duke mundësuar kalimin automatikisht në vit të dytë Master në FGJH.
2. **ITIRI – Strasburg, Francë** mundëson regjistrimin në vitin e dytë Master, emërtimi Gjuhë dhe Ndërkulturalitet, specialiteti Përkthim profesional dhe Interpretim, dega Përkthim Profesional në Universitetin e Strasburgut.
3. **Scientific College of Greece, Athènes, Greqi** / **Master në Përkthim profesional, Master 2 në Interpretim** / <https://scg.edu.gr/>
4. **Institut Français de Thessalonique / I.F.T. Master 2. Përkthim profesional**  
[http://www.ift.gr/fr/component/k2/item/172-examen\\_entree\\_master\\_trad\\_pro\\_itiri](http://www.ift.gr/fr/component/k2/item/172-examen_entree_master_trad_pro_itiri)
5. **Istituto Superiore per Interpreti e Traduttori de Milan Itali** / I.S.I.T. Master ne Conference Interpreting International Communication, <http://www.fondazionemilano.eu/lingue/english>
6. **Université Hacettepe, Ankara (Turquie)** / Université Hacettepe  
[http://www.mtb.hacettepe.edu.tr/fmtprog\\_en.php](http://www.mtb.hacettepe.edu.tr/fmtprog_en.php)
7. **l'Université des Langues d'Azerbaïdjan / A.D.U.**

Për ndjekjen e vitit të dytë, studentët mund të përfitojnë nga programe të ndryshme financimi të tilla si programet ERASMUS+<sup>3</sup> apo edhe mundësi të tjera financimi.

## SHTOJCA 1

### SAKTËSIMI RRETH PROCEDURËS SË TESTIMIT ME SHKRIM DHE ME GOJË

Konkursi i pranimit në këtë master përmban një testim me shkrim dhe një testim me gojë.

- ✓ **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në muajin nëntor (data, ora dhe vendi do të njoftohen në një njoftim të dytë) dhe do të konsistojë në përkthimin 4 teksteve të shkurtra sipas kombinimeve gjuhësore A-B, B-A, A-C dhe C-A<sup>4</sup>.
- ✓ Kandidatët të cilët kanë frëngjishten gjuhë B ose C dhe që dëshirojnë të ndjekin vitin e dytë master pranë ITI-RI-së, duhet t'i nënshtrohen gjithashtu një testimi për gjuhën frënge. Modalitetet e këtij testimi do të përcaktohen në një kohë të dytë.
- ✓ **Testimi me gojë** do të zhvillohet në muajin nëntor (data, ora dhe vendi do të njoftohen në një njoftim të dytë), ku kandidatëve, sipas kombinimeve gjuhësore të tyre, do t'u jepen tekste nga aktualiteti politik, ekonomik, kulturor, etj, të cilët duhet t'i përgatisin brenda një kohe prej 10 minutash secilin. Më pas kandidati paraqet përpara komisionit një përmbledhje të shkurtër të teksteve në fjalë. Kandidati do t'i nënshtrohet dhe pyetjeve të tjera që kanë të bëjnë me motivimin dhe arsyet e përzgjedhjes së këtij Masteri. Kohëzgjatja e testimit me gojë varion nga 20-30 minuta për kandidat.

*Shpallja e rezultateve:* Brenda javës që pason testimin me gojë komisioni, i përbërë nga pedagogë të FGJH-së dhe ITI-Ri-së, duke marrë parasysh rezultatet në të dy testimet, shpall kandidatët fitues

<sup>3</sup> <http://erasmusplus.al/sq/?p=2061>

<sup>4</sup> A- Gjuha amtare (shqipe), B- gjuha e parë e huaj, C- gjuha e dytë e huaj